



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-5107/11,për Zyrtarin e Lartë z.Muhamet Sadiku, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit, ne Qeverinë e Republikës e Kosovës, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-5107/11,që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Muhamet Sadiku, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit, ne Qeverinë e Republikës e Kosovës

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit, ne Qeverinë e Republikës e Kosovës

ka qenë i regjistruar ne Agensionin për Regjistrimin e Bizneseve si Kryetar i Bordit dhe bashkëpronarë ne Shoqërinë Aksionare “Universiteti Rinvest SH.A” dhe ne te njëjtën kohe ka ushtruar edhe funksionin e zyrtarit te Lartë si Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit, që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 01.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Muhamet Sadiku, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit, ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë si dhe ka kërkuar të ballafaqohet me faktet që posedon Agjencia.

Me datën 27.03.2012, jemi takuar z.Muhamet Sadiku, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit, në zyrat e Qeverisë, gjatë takimit është biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lartë, z.Muhamet Sadiku, gjatë takimit është pajtuar për situatën mir po është arsyuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar as kush që nga momenti i zgjedhjes si, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mundë të shkaktoj Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, pasi që ka menduar se nuk ka lidhje me funksionin publik si Këshilltar politik dhe në anën tjetër si kryetar i bordit në Shoqërinë Aksionare "Universiteti Riinvest SH.A"

z.Muhamet Sadiku, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit është zotuar se në afatin ligjor do të ndërpres punën si Kryetar i Bordit në Shoqërinë Aksionare "Universiteti Riinvest SH.A"

ku është edhe bashkë aksionarë, dhe do ta bëjë shmangien Konfliktit të mundshëm të Interesit duke u larguar nga pozita e Kryetar i Bordit gjatë kohës sa ushtron funksionin Publik si Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit.

Me datën 11.05.2012, Zyrtari i Lartë, z.Muhamet Sadiku, Këshilltarë Politik i Zëvendës Kryeministrit, ka sjellë dëshminë se është tërhequr nga pozita e kryetarit të Bordit në Shoqërinë Aksionare "Universiteti Riinvest SH.A."

Me anë të dokumentit të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve, dëshmohet se z.Muhamet Sadiku nuk është me Kryetar i Bordit në Shoqërinë Aksionare "Universiteti Riinvest SH.A" por ka mbetur vetëm si bashkëpronarë, andaj kundërojmë se z.Muhamet Sadiku ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

